

# Rrugët e Jezu Krishtit

## Rrugët e Jezu Krishtit:

kontributet e tij për vetëdijen njerëzore dhe për ndryshimet e njerëzimit dhe Tokës: një faqe informative e pavarur, me pikëpamje të reja nga shumë sfera të përvojës dhe të hulumtimit; me udhëzime praktike për zhvillimin personal.

shqip.

→



Ky është një version i shkurtër në shqip:

[Jezu dhe feja islame](#)

[Feja si „rilidhje“ e njeriut me Zotin – nëpër rrugët me Jezun](#)

[Bazat e vlerave etike - nëpër rrugët me Jezun](#)

[Aspekte krishtere për ekonominë dhe për çështjet sociale](#)

Tekste më të gjera rreth hapave në ungjij dhe rreth zbulësës, e tema\* të tjera ofrojmë në [shumë gjuhë](#), p. sh. në [faqen në anglisht](#). Kjo aktualizohet rregullisht.



Kjo është faqja <http://www.ways-of-christ.com/sq>

\*) Teksti më i gjerë në disa gjuhë të tjera përmban: **Teksti kryesor pjesa 1:** Hyrje në kuptimin dhe përdorimin e këtij teksti, me udhëzime metodike rreth meditimit mes tjerash; „Në fillim ishte fjala“ „dhe fjala u bë mish...“; Jezu nga Nazareti: lindja e tij; me faqe ekstra rreth rilindjes në kuptimin e krishterë; A gjendet diçka e rëndësishme në vitet e rinisë së Jezu?; Një vërejtje periferike rreth diskutimit për „dy çuna Jezu“; Rreth pagëzimit në lumin Jordan nga Gjoni pagëzuesi; me faqe ekstra: shënime rreth pagëzimit të tanishëm; Qetësia në shkretëtirë; Tundimet; Dasma në Kana; (Pikëpamje të krishtera rreth seksualitetit, simpatisë, ndjenjës dhe dashurisë); „Zelli i shenjtë“ (dhe pikëpamje rreth emocioneve); Rreth Predikut në mal (me pikëpamje rreth arsyes); Shndritja e Krishtit në malin Tabor; Çështja e „veprave të mrekullueshme“; Ringjallja e L Lazarit; „Delet“; Krishti dhe larja e këmbëve; dhe krezmimi në Betani (pikëpamje të rëndësishme të spiritualitetit të krishterë); Darka e mbrame, robërimi dhe fshikullimi; Kurora me gjemba dhe fjalimet përshëndetëse; Kryqëzimi dhe varrosja, me udhëzime nga mistika e krishterë; Çështja e varrit të zbrazët, të „rrugës së ferrit“, të „rrugës së parajsës“; Ringjallja; Ngjitja në qiell, Ngritja; Ngjarja e rrëshajës; Një portret i Jezusit. **Teksti kryesor pjesa 2:** Zbulesa e Gjonit; Rreth sjelljes ndaj profetizimeve; Rreth përmbajtjeve të apokalipsës së Gjonit; Shtatë kishat – me faqe ekstra rreth kishave të sotme gjegjësisht drejtimeve teologjike dhe rreth okumenës; Shtatë vulat; Shtatë trombonat; „Shtatë bubullimat“ dhe dy profetët; Gruaja dhe dragoi; Kafsha

shtatëkokëshe nga deti; Kafsha dy-brirëshe nga toka; „Shtatë mundimet e fundit" dhe fundi i „Babilonisë", dhe ardhja e dytë e Jezuit; „Perandoria e paqes 1000vjeçare" (e vërtetë); „Qielli i Ri, Toka e Re dhe "Jerusalemi i Ri"; Kapitulli përfundimtar: E krishtera; Tabela: Një qëndrim i krishterë - "Në botë, por jo nga bota", një "Botë e Tretë"; Udhëzime për cilësinë e paraqitjes, një version i shtypur, dhe të drejtat; **3: tema të tjera:** Një lutje për paqen, jetën dhe tokën; Vlerat themelore etike; Një korrigjimi i shkurtër mbi teoritë moderne për zbulimin e të vërtetës rreth Jezuit; Jezusi dhe të ushqyerit njerëzor; Shkenca natyrore dhe besimi në zot; Jezusi dhe shërimi – edhe në ditët e sotme; Bekimi; Pikëpamjet e krishtera mbi çështjet ekonomike dhe sociale; Pikëpamjet e krishtera mbi shoqërinë dhe politikën; Filozofia dhe Krishterimi - një koment për një fjalim të bërë nga Habermasi "Besimi dhe Dituria"; **Ekologjia dhe krijimi i jetës së pa-lindur; Këto faqe dhe drejtimet e teologjisë së krishterimit;** meditimi i krishterë; Inspirimi dhe kishat; Çështja e jetës pas vdekjes dhe domethënia e saj për jetën e kësaj bote; Krishterimi dhe marrëdhëniet e saja për të mësuar mbi "fatin" dhe "reinkarnimin"; ... **4. Dhiata e vjetër dhe kontributet për dialog me fetë tjera:** Dhiata e vjetër, religjioni herrej dhe Jezusi; Jezusi dhe religjioni islam; Budizmi; Zoroastrianizmi (Parsizmi); Hinduizmi; Taoizmi dhe Konfucianizmi; Shintoizmi dhe religjionet indigjene; Religjioni si një "ri-lidhje" në mes të njeriut dhe zotit.

[copyright, e-mail](#)

[bibël](#)

## Informata rreth : Jezu Krishti dhe feja islame

### Dialogu ndërfaqor

Ky është një kontribut për kuptim më të mirë ndërmjet religjioneve dhe për një "dialog ndërfaqor" paqësor, siç po ndodh veç disa vjet. Këto shënime nuk ngritin pretendimin që ta karakterizojnë fenë islame në përgjithësi; veçmas meqë ekzistojnë shkolla të ndryshme të fesë islame.

### Kurani\*) dhe fetë e tjera të shkruara.

Islam do të thotë "nënshtrim nën vullnetin e Zotit".

Libri i Shenjtë i fesë islame, Kurani, kuptohet si inspirim që iu komunikua profetit Muhamed përmes Zotit përkatësisht engjëllit Xhibril, i cili mund të identifikohet edhe me kryeengjëllin Gabriel të njohur edhe nga feja e krishterë. E sigurt është që Kuranit do t'i binte rëndësi qëndrore. Përveç kësaj për interpretim një rol luajnë edhe traditat e tjera (suna; d.m.th. zakone) të trashëguara nga koha e profetit (Hadithi). Edhe një profet në sjelljet e tij personale është njeri, nuk është Zot. Duhet të merret parasysh, se njëjtë sikurse tek të krishterët, kemi edhe myslimanë që nuk e njohin saktësisht Librin e tyre të Shenjtë.

Të krishterët përkatësisht hebrenjtë në Kuran përmenden pjesërisht edhe drejtpërdrejt si "ju ithtarët e shkrimit" (ithtarë të librit, p.sh. surja 4:171\*) dhe si "ju fëmijë të Izraelit). Kështu ata mund të merren edhe me Kuranin\*) e shenjtë, edhe kur këtë kryesisht nuk e bëjnë. Shkenca fetare merret megjithatë me Librat e Shenjtë të të gjitha feve dhe hulumton mes tjerash edhe zhvillimin historik të interpretimit të tyre. Por, Librat e Shenjtë do të duhej të studiohen me respekt. Njëra pjesë e komentuesve myslimanë të Kuranit shkruante, se ekziston një formë origjinale e Kuranit, e ruajtur mirë tek Zoti, në të cilën qasje mund të kenë vetëm engjëjt e pastër dhe të dërguarit e pastër njerëzorë; një pjesë tjetër e tyre interpretonte, se lexuesi i Kurani që ekziston në Tokë do të duhej të jetë në gjendje të pastër.

Profeti vlen si i dërguar për një "kohë" (ose "ndërkohë") kur të dërguarit kanë munguar (surja 5,19\*). Kurani i dallon besimtarët në kuptimin e e mësimëve të profetit Muhamed në "ithtarë të librit" (njerëz të shkrimit) dhe "mosbesimtarë". Me "ithtarë të librit" nënkuptohen veçanërisht hebrenjtë dhe të krishterët, të cilët

krahas myslimanëve mbështeten mbi të njëjtën traditë, nganjëherë edhe zjarrputistët (surja 22,17). Ngaqë Kurani njih edhe një zinxhir të "profetëve", të cilët të gjithë kanë dhënë mësim të përputhshme për një Zot, për Gjyqin e matanshëm dhe lutjen për popujt e tyre përkatësisht për kohën e tyre (p.sh. suret 6, 83-92; surja 7, surja 4,136\*). Përderisa njerëzit e këtyre feve besojnë në bazat e përbashkëta, ata në vetë Kuran nuk llogariten si mosbesimtarë (surja 5,48\* etj.). Në shekujt e parë të fesë islame nuk është ushtruar detyrim ndaj të krishterëve dhe hebrenjve që të kalojnë në fenë islame (sipas mësimin në Kuran, "në fe nuk ka detyrim", shiko suren 2, 256\*).

Abrahami vlen si njëri prej "hanifëve", që si individë drejtpërsëdrejti kanë gjetur fenë e vërtetë në një Zot të vetëm.

Allah – në arabishten e vjetër paraislamike al-ilah – si fjalë semitike ka sigurisht të njëjtën origjinë si "Elohim", një emër i Zotit nga libri hebraik i Moisiut.

Si "mosbesimtarë" – fjalë për fjalë përafërisht: "mbështjellës"- në kuptimin e rreptë në kohën e profetit Muhamed vlenin politeistët përkatësisht idhujtarët, kundër të cilëve ai luftonte në Arabi, dhe prej të cilëve ka paralajmëruar qysh edhe Bibla e hebrenjve dhe e të krishterëve. Në kuptimin e gjerë sot në fenë islame si mosbesimtarë vlejnë ata që nuk besojnë në Zotin e vetëm dhe në gjykim. Ndonjëherë ky term përdoret gabimisht në mënyrë paushale për të gjithë jomyslimanët; ndonjëherë madje edhe për myslimanë të drejtimit tjetër.

## **Jezu Krishti në Kuran.**

Duhet të udhëzohet se Kurani e njih Jezusin në disa vende si profet; si të dërguar të Zotit, e edhe si "fjalë" e Zotit me një domethënie të pasqaruar më saktë dhe si një frymë e Zotit (surja 4,171), "të krijuar si Adami" (suret 2, 3, 5, ...). Në një fe islame të kuptuar mirë ai vlen me çdo kusht më shumë se sa tek ata teologë të krishterë modernë, të cilët e lanë vetëm reformatorin social Jezusin. Vetëm mësimi për birësimin e Jezusit nga Zoti, nga të krishterët e kohës së Muhamedit qysh atëherë e kuptuar shumë tokësore, në kuadër të diturisë së mëvonshme të trinisë nuk është pranuar në Kuran. Të krishterë, të cilët atë me të cilën mendohej kanë mundur ta sqarojnë në mënyrë aq autentike, që edhe njerëzit me pikënisje të tjera ta kuptonin, gati se nuk kishte më. (p.sh. surja 6, 101\*). Në Romakët 1.4 thuhet, se Jezusi në fuqinë e tij të frymës së shenjtërisë u "vendos si bir", do të thotë nuk u lind.

Me bindjen myslimane se Zoti i është i palindur dhe Jezusin nuk e lindi, por e krijoi, me këtë mund të pajtohen deri këtu në të vërtetë të krishterët. Më tej është termi (greqisht) "logos", i cili në Bibël përdoret pikërisht për prejardhjen gjegjësisht dërgimin hyjnor të Jezu Krishtit, në ungjijtë është përkthyer edhe si "fjala" (shiko lart), e cila në Kuran përdoret për Jezusin. A janë të fshehura fshehtësi në inspirimet e Kuranit sikurse në Bibël, të cilat nuk janë zbuluar krejtësisht as nga myslimanët e as nga të krishterët, ashtu që grinden kot për terme? Edhe ku të krishterët këto mësimë i prezantojnë ashtu që mund të kuptohen si "mësimë të shumë perëndive", kjo nuk i përgjigjet natyrës se si mësonte vetë Jezusi: "Lutuni në emrin tim (d.m.th. të lidhur ngushtë me Jezusin) te Ati (Zoti)" – Bibla, ungjilli sipas Gjonit 15:16. Gjithçka në jetën e Jezusit sillet rreth një Zoti, me të cilin është i lidhur ngushtë dhe te i cili pikërisht ai mund t'i dërgojë njerëzit.

Termi "Logos" (greqisht, në ungjillin e Gjonit 1 "fjala e Zotit", një emërtim që aty është i lidhur me Krishtin), në Kurantin e përkthyer nga Paret-i (gjermanisht) përmendet pavarësisht nga Jezusi, por në botimet e tjera të Kuranit nënkuptohet si "çështje" e Zotit përkatësisht si "urdhër" i Zotit (surja 13,2 dhe 13,11\*).

Kurani e shikon Jezusin "si Adamin", të cilin Zoti e krijoi nga dheu (surja 3,59\*) dhe flet për një "të dërguar të Zotit" nga Fryma e Zotit, e cila ndërmjetësoi lindjen virgjërore të Jezusit nga Miriami (Maria) (surja 19,17-22\*). Në versionin e krishterë engjëlli i Atit e paralajmëron lindjen e Jezusit nga Fryma e Shenjtë. Po ashtu në Kuran thuhet se Jezusi u forcua me Shpirtin e Shenjtë / Frymën e Shenjtësisë (surja 5,110\*).

Sipas Kuranit Jezusi i ri ka paralajmëruar ringritjen e tij (surja 19,33\*), me të cilën mund të jetë menduar edhe rikthimi i tij në "ditën e gjyqit" (gjykimi), një ringjallje e besimtarëve që përmendet shpesh në Kuran (shiko poshtë, surja 4,159\*). Kurani flet për atë se Jezusi për së gjalli është ngritur në qiell (surja 4,157 -

159\*, *surja 3,55\**).

Myslimanët dhe të krishterët nuk janë të një mendimi, se a u kryqëzua Jezusi para shkuarjes së tij në qiell, vdiq dhe përmes Zotit e mundi vdekjen, siç thonë të krishterët, apo pa kryqëzim i gjallë u ngritë në qiell, siç e besojnë myslimanët. Por i përbashkët është besimi, se në kohën kur u ngritë në qiell kurrsesi nuk ishte "i vdekur", por p.sh. i këshillonte njerëzit.

Qysh në suret 3,55\* përkatësisht 5,48\* thuhet, se "...unë do ta shpëtoj" dhe "...të gjithë do të ktheheni tek unë, dhe unë (Zoti) do të gjykoj mes jush për atë që kundërshtoheshit (në jetën tokësore)". Zgjidhjen e disa fshehtësive të mbetura, të krishterët dhe myslimanët mund ta presin në qetësi, në vend që të grinden.

Në mënyrë të njëjtë Kurani përmban ringjalljen e besimtarëve në kohën e gjyqit (*surja 36, 77-83; surja 69, 13-37; suret 75 dhe 99\* etj.*). Jezusi do të vjen pastaj përsëri dhe të jetë dëshmitarë për njerëzit besimtarë të shkrimit (*surja 4,159; krahaso suren 16,89\**). Ata, edhe jomyslimanët, që besojnë në Zot dhe në Ditën e Gjyqit, dhe bëjnë çka është e drejtë, sipas Kuranit nuk kanë nevojë të frikësohen nga gjyqi (*suret 2,62; suret 4,123-124; surja 7,170\**). Gjyqi në Kuran sikurse edhe në Bibël është qartë një çështje e Zotit dhe jo një çështje e njerëzve, qofshin ata të krishterë, myslimanë apo hebrej.

(Krahasimet e tilla mes feve këtu nuk shërbejnë për të vënë në dyshim pavarësinë e Kuranit.)

## Rreth bazave etnike të fesë islame dhe të krishterimit

Edhe bazat etike të 3 "religjioneve abrahamitike" janë të lidhura ngushtë. Urdhëresat paraqiten edhe në fenë islame, edhe pse jo të renditura në listë, *mes tjerash në suren 17,22-39; suren 5,38-40; suren 2,188; suren 4,135; suren 2,195; dhe suren 17,70\* (dinjiteti i njeriut)*. Kurani p.sh. ndalon rreptë dhe pa përjashtim vrasjen e të pafajshmëve (*surja 5,27-32\**). Termi "**Gihad**" (**xhihad**), do të thotë vetëm: "luftë"; domethënia "Luftë e Shenjtë" nuk rrjedh në këtë kuptim nga Kurani, por nga maksimat e profetit Muhamed dhe të shkollave islamike të drejtësisë \*\*\*): Puna frymore-morale në brendinë pranë pasioneve vetjake e të largëta me Zotin, vlen si "Xhihadi i Madh", të cilës i kushtohet domethënie më e madhe se sa të gjitha debatimeve të jashtme. (*krahaso p.sh. prpsinë e Jezusit, "së pari të nxirret thumbi nga syri yt..."* – Shumë konflikte të jashtme do të humbin kështu bazën e tyre.) "Xhihadi i fjalës" është përfaqësimi paqësor i besimit. "Xhihadi me dorë" është shembulli veprues, mësimdhënës i besimit. "Xhihadi i shpatës" quhet edhe "xhihadi i vogël"; ai u lejohet vetëm për mbrojtje besimtarëve të sulmuar dhe "pa shkelje" (*krahaso Kurani, surja 2,190\**). "Intensiteti" i sjelljes ndaj atyre që besojnë ndryshe është i përcaktuar edhe në Kuran (*surja 48,29\*, surja 47,4\**).

Të gjera janë rregullat tradicionale për sjellje ndërmjet gjinive, duke përfshirë edhe ndalimin e martesës me pjesëtarët e feve të tjera, e kështu me radhë.

Në praktikën islamike bëjnë pjesë: "Dëshmia, se zot tjetër përveç Zotit (Allahut) nuk ka dhe Muhamedi është i dërguari i Zotit";

që të kryhen lutjet e parashikuara ditore (*surja 2,177\**);

që të përmbahet agjërimi vjetor në muajin ramazan (*surja 2,185\**);

që të zbatohet mundësisht një herë në jetë haxhillëku (*surja 2,196\**);

dhe të paguhet zakati (taksa për qëllime sociale) (*surja 2,177\**)"

Në fenë e sotme islame nuk ekziston ndonjë pikë qendrore, e cila vendos për çështje fetare-etike.

Megjithatë pozitat që mbahen nga një shumicë e dukshme e dijetarëve të falshëm juridikë, do të gjenin sipas të gjitha mundësive një pranim të gjerë.

\*) Është përdorur mes tjerash "*Kurani, përkthim nga Rudi Paret*", *Kohlhammer-Verlag (gjermanisht)*, i cili përkthim i kënaq pretendimet shkencore, dhe dallon dukshëm mes përkthimit dhe shënimeve fjalë-për-fjalë për kuptimin më të mirë gjuhësor. Këtu përdoret numërimi egjiptian i verseve që përdoret më së shumti në hapësirën islamike.

Përkthime të tjera mund të përdorin njërën prej dy numërimeve të tjera të verseve; atëherë pikën e përmendur e gjeni pak para ose pas numrit të përmendur të versit në të njëjtën sure. Përkthyeshmëria e rëndë e Kuranit nuk vlen aq shumë për pika të tilla të qarta, sikurse ato të dhënat. Domethënia e pikave të Kuranit është krahasuar edhe me

"Kurani, i përkthyer dhe i komentuar nga Adel Theodor Khoury, 2007 (gjermanisht)" përkthimi i të cilit ka gjetur njohje edhe tek dijetarët myslimanë, (p.sh. Dr. Inamullah Khan, Sekretar i atëhershëm i Përgjithshëm i Kongresit Botëror Islamik.), dhe komenti i tij merr parasysh interpretimin tradicional të shkollave islamike të drejtësisë.

\*\*\*) Edhe "kryqëzatat e krishtera" historike nuk ishin të arsyetuara në Bibël, por ishin vepra njerëzore, dhe kanë p.sh. sot një famë të keqe tek shumë të krishterë evropianë.

## Rrugët e Jezu Krishtit

### Feja<sup>1)</sup> si "lidhje kthyesë" e njeriut me Zotin – rrugëve me Jezu Krishtin

1) Fjala religjion rrjedh nga latinishtja religio = rilidhje; me Zotin, i cili nga brendia merr formë edhe tek ne. Duke e krahasuar larg me një hologram, diçka e ngjajshme ndodh edhe në të madhe.

### Njohuri e problemeve më të thella në jetën njerëzore

Sikurse për një shërim përmes lutjes, edhe për shndërrimet e mëtejme në njeriun do të ishte së pari pyetja e Jezu „A dëshiron të shërohesh?” (*Gjoni. 5,6*). **Gjegjësisht, a e din se cilat mospërsosshmëri ende i ke, të cilat duhet të shndërrohen, nëse në rrugën kah Zoti dëshiron të ecësh përpara?** Një „fije e kuqe” mund të gjindet prapa ndodhive që duken krejt të thjeshta, që rrallëherë shikohen si religjioze. Në rritjen e një fëmije nëpër rini deri tek mosha madhore fitohen aftësi të reja; gjatë së cilave megjithatë shpeshë fshihen aftësitë fillestare të të përjetuarit. Më vonë njeriu me ndihmën e kujtesës dhe lutjes kërkon t’a fitojë sërish këtë mënyrë të mbuluar natyrore të të përjetuarit. Aftësitë e rritura gjatë kësaj megjithëkëtë mbahen, përderisa forcimet e qenies prapë zbuten ose zbërthehen. Ndarja e njeriut, në intelekt dhe në jetën epshore të pavarësuar, ndarje kjo e krijuar në jetë përmes „thyerjeve” shpirtërore-mendore ose të jashtme, dhe aty ndërmjet një mes vetëm edhe pak i integruar në „zemër”, mundet kështu në rrugë të ndryshme prapë të bashkohet më fortë. Mundet të tregohet se „fruti nga pema e njohjes” në mitin e parajsës bazohet në këtë ndarje; dhe thënia „Në qoftë se nuk ktheheni dhe nuk bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni fare në mbretërinë e qiejve” mbështetet në njohjen më të thellë të mundësisë së kthimit - *Jezusi në Mateu 18, 1-3; Marku 10,15; Luka 18, 17*. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për paanshmërinë fëmijërore, por për bazat fillestare të zhvillimit, të cilat madje janë „arketipike” <sup>2)</sup>, d.m.th. mostra themelore të parashkuara, një pjesë e humbur e një „udhëzuesi për përdorim” të njeriut. Kjo rrugë mund të shpie shumë më tej se sa vetëdija e arsyes që sot është e kufizuar.

2) „Arketipik” është një shprehje nga psikoanaliza e C. D. Jung etj.; mostra themelore të ekzistencës njerëzore të përjetueshme si figura të ndryshme. Sidoqoftë "pikëpamjet arkaike" bartin gjithashtu edhe përmbajtje mashtruese. "Zoti" i paraqitur si një burrë i vjetër, dhe hollësitë mbi "Parajsën" dhe "Ferrin" janë të tillat "pikëpamjet arkaike" të "pa vetëdijes kolektive". Se çfarë ishte kjo saktësisht, Jung nuk e dinte. **Së paku një thelb i këtij niveli të vetëdijes me pikëpamjet dhe paramendimet e veta të ngulitura në koka njerëzish, së fundi është pak a shumë i pranishëm tek të gjithë njerëzit. Dhe me këtë kjo buron si një lloj i kujtesës arkaike nga një kohë e mëparshme e njerëzimit – bile nga kohërat e panjohura si ato të "vetëdijes mitike" (...). Ky nivel i vetëdijes përmban gjithashtu edhe kontradikta vetëm të dukshme, siç i përjetojnë njerëzit në jetën e tyre (...). Gjatë vrojtimit më të afërt, dukja e zotit e këtij niveli duket më tepër si një karikaturë problematike e zotit. (...). Përrallat kanë tentuar të e trajtojnë këtë botë të simboleve, gjë që për fëmijë mund të ketë gjithsesi një kuptim. Mirëpo të rriturit mund të tentojnë të dalin jashtë këtyre simboleve – të cilat kanë marrë shumë pamje njerëzore-. Gjëja artistike me këtë rast është të kërkohej zoti direkt, në vend që ai me njëherë të lihet anash.**

Kjo nuk do të thotë, se njeriu mund t’ia dal me forcën e vet. Jezu ofron një rrugë reale, dhe fuqinë gjegjësisht mëshirën që asaj t’i dal zot. Kërkes, mistikë dhe alkimistë të krishterë të së vërtetës kanë kaluar shumë qartë rrugë të tilla të përkryerjes (*krahaso p.sh. Mateu 5,48; Gjoni 10,34;...*). Edhe shumë të krishterë të tjerë vetëdijshëm ose jovetëdijshëm kanë krijuar përvojë në këtë drejtim. Kjo është e pavarur

nga ajo, se a kanë shkuar një rrugë më tepër të brendshme, ose a e kanë realizuar besimin e tyre më tepër në mënyrë sociale, ose a i kanë bashkuar të dyjat, në kuptimin e një „krishtërimi të plotë" siç e quajmë ne. Me dekada të tëra, në shumë kultura është kërkuar tejkalimi i përçarjes së brendshme të njerëzve; edhe synimi i alkimistëve taoistë, llojet e ndryshme të jogës, etj. japin dëshmi për këtë <sup>3)</sup>.

<sup>3)</sup> Fjala indiane Yoga, fjalë për fjalë „vë në zgjedhë" do të thotë edhe kërkim i një rilidhjeje me origjinën e të gjitha sendeve, me amshimin. Kjo nuk do të thotë, se një rrugë tjetër e tillë duhet të shpie në të njëjtin cak sikurse rruga e krishterë.

„Njeriu Zot" ose njeriu i dërguar nga Zoti Jezu Krishti, „Adami i ri" paraqet sinjalin, se qysh atëherë edhe njerëzit mundën përsëri të fitojnë tiparet e tyre fillestare të derdhura; dhe se ka ardhur koha që të përmirësohen shtrembërimet që në ndërkohë janë bërë të rrezikshme. Ai mundet në vete të bashkojë, si „rast fatlum" për Tokën, lidhjen ndaj burimit fillestar të kuptimit të jetës, Zoti, dhe vetëdijen njerëzore me zhvillimin më të lartë. Fuqitë e degjenerimit ai mund t'i tejkalojë. Edhe nëse tregon dallime ndaj njerëzve të tjerë, megjithatë ai ishte poashtu njeriu, i cili këtë mund t'a zbatonte në këtë mënyrë. Kështu njerëzit mundën këtë rrugë më lehtë t'a kuptojnë, veçanërisht nëse këtë e bëjnë vetëdijshëm. Por edhe vet për të tillët që nuk dijnë asgjë për Jezusin historik, jeta e tij duke përfshirë edhe ringjalljen nuk është pa ndikime, ngjajshëm sikur p.sh. nëse kafshët në një ishull mësojnë edhe diçka, kafshët e llojit të njëjtë në ishuj më të largët përnjëherë edhe më shpejt mund t'a mësojnë këtë aftësi, pasi që kanë një lloj fushe të përbashkët të forcës, siç ka vërejtur p. sh. R. Sheldrake.

Një lidhje e brendshme e njeriut ndaj Krishtit dhe ndaj Zotit është e mundshme së pari edhe pa ndërmjetësim kishtar; edhe nëse një bashkësi gjithnjë e përshtatshme e të bashkëkrishterëve kryesisht është një ndihmë. Teologjitë kontradiktore, të cilat qenien e tërësishme të Krishtit prapë e kishin ndarë në një përkujdesës priftnor dhe një reformator social, nuk mjaftojnë më për këtë; edhe nëse disave mund t'ju japin përkrahje, posaçërisht nëse njohin disa prej teologjive. Secili njeri i veçantë mund t'i përshtatet direkt Jezusit p.sh. „mbyllur në vetvete", por në fund edhe në treg. Kjo mund të ndodhë në njërin anë me ndihmën e kujtesës së tipareve të tij të trashëguara (ungjijt). Por kush është i hapur për atë që Krishti të mundet të perceptohet edhe pas vdekjes së tij, (sikur edhe në mënyrë tjetër, mes tjetash edhe pa këtë dukshmëri tokësore, edhe secili njeri sipas dëshmive të shumta vdekjen e mbijeton si qenie e vetëdijshme), Krishti mund të trajtohet edhe si veprues aktual. Të ndierit bëhet i mundshëm „në emrin e tij" gjegjësisht me të si 'vëlla të madh' së bashku të lutën tek Zoti baba, i cili të gjithë i mbëshjellë. (krahaso Gjoni 15,16; Mateu 6, 7-15; Mateu 18,19-20). P.Sh.:

Zot, prejardhja ime, ndihma ime dhe shpresa ime!

Të bashkuar me Jezu Krishtin \* të falënderit për gjithëçka që vjen prej teje;  
më fal atë çka më ka larguar prej Teje \*\*;  
të lutem më lerë në këtë qetësi që përmes Frymës Tënde të bëhem krijues \*\*\*;  
më tërhiq kah Rruga Yte.

\*) Kush e shikon të rrugës, mund t'a përfshijë edhe Marinë. Edhe tiparet mashkullore dhe femërore të njeriut ngriten përpjetë kështu.

\*\*) Më tej mundet çdo tendosje që ndihet negativisht, siç paraqitet konkretisht, 1. të shikohet përbrenda (p.sh. trembja, mllefi, indiferenca dhe prepotenca; dyshimi i tepruar, ...ose një problem; gjithëçka edhe nëse vetëm paraqitet në mendime ose fjalë, krahaso p.sh. Mateu 5, 22). 2. në vend që të vritni mendjen më pas, pritni një moment qetë, ashtu që mundësisht të bëheni të vetëdijshëm, se për çka është fjala. Pastaj 3. këtë balast që është bërë i kuptueshëm, madje fizikisht i ndjeshëm në lutje i'a përcjellë Zotit (veç kësaj është e mundshme, tërë rruga e mëtejme jetësore t'i dorëzohet Zotit gjegjësisht Krishtit) 4. pritet qetë derisa kjo eventualisht bëhet e ndjeshme gjegjësisht paraqitet një gjurmë e lehtësimi, ose krijohet edhe një „përgjigje" në vetëdije.

\*\*\*) Në heshtje ngjarjet e ditës mund të „qetësohen" dhe kështu që ato bëhen më të afrueshme për përpunim gjegjësisht për lutje. Atëherë aty ka prapë më shumë çiltërsi për gjëra të reja.

## Domethënia e etikës në këtë rrugë

Një rrafsh në këtë rrugë është "**dashuria ndaj Zotit**", i cili qëndron mbi të gjitha „**dhe ndaj të afërmit si ndaj vetes**" (*Mateu 19, 19*); do të thotë edhe ndaj vetes; të duash veten, mund të jetë poashtu pjesë e përpjekjes që të njohësh detyrën e tij në rrethinë. Dashuria mundet të lidhë me Krishtin, sepse është tipari i tij kryesor, **i lidhur me mençurinë**. Edhe rruga e Veprës së Mirë në frymën e Krishtit shpeshherë në ndikimet e brendshme dhe të jashtme e bënë tek të kuptueshme rrugën e krishterë. Jezu i ka mbajtur rregullat themelore etike të caktuara; sepse njeriu „korrë (normalisht), atë që ka mbjellë" (*Gal. 6, 7*); por përgjegjësinë e ka shtruar më fort mbi individin, sesa t'a theksojë ligjin e jashtëm. Gjatë kësaj mund të përjetohet, se në brendinë e vet të njeriut ka diçka, edhe nëse mund të ndjehet vetëm si ndërgjegje, e cila qëndron në harmoni me Krishtin, nga e cila ndodh një lloj „rilindjeje" e brendshme (*Gjoni 3*). Do të thotë me kalim të kohës njeriu si i tërë bie gjithnjë e më tepër në harmoni me frymën, siç e ka jetuar më parë Krishti. Kjo pikënisje në brendi mundet të përjetohet në zemër ose në shpirt gjegjësisht frymë, llojet e përjetimit janë individualisht të ndryshme. Sidoqoftë se si individi/individja e përjeton Krishtin gjegjësisht forcat që lidhen me të, është e logjikshme që sa më shumë të jetë e mundshme të thirret në ndërgjegje, çka veçmë është e njohur individualisht, në mënyrë që një kontakt më direkt të mund të ndërtohet mbi të, edhe nëse fillimisht nuk mund të konstatohen kurrfarë ndikimesh të dhunshme.

Me forcën, e cila kështu zhvillohet si mëshirim në brendinë e njeriut, mund të lidhet pastaj forca shëruese universale që afrohet prapë nga „jashtë" nga Krishti gjegjësisht Zoti. Edhe këtu lloji individual i të përjetuarit mund të jetë shumë i ndryshëm, ajo megjithatë në këtë rast do të jetë e qartë dhe do të ketë ndikime përkatëse edhe për mjedisin. Përderisa thellësishtëmëri të tilla deri tani ishin të kufizuara në pak veta, të cilët pastaj vlenin si „mistikë", „të shenjtë" etj., dukuri të tilla në kohrat tona „apokaliptike" mund të zgjerohen edhe tek njerëzit, gjë që sipas mundësisë nuk njihet gjithmonë menjëherë në rëndësinë e saj; prandaj duhet këtu poashtu të përmendet. Ky ndikim universal „nga jashtë" ose pranohet ose nën rrethana përplaset dhimbshëm mbi barrikadimin e atyre, të cilët në brendinë e tyre nuk kanë përhapur asgjë të afërtë, kështu që në këtë rast mund të ndihet si „gjyq".

Më udhëheq, ashtu që të mos i dëmtoj të tjerët në rrugën e tyre tek Ti;  
më prijë, t'u ndihmoj të tjerëve në Frymën Tënde;  
më mbroj në rrugën time; \*  
Më ndihmo për kah harmonia më e madhe me dashurinë Tënde.

\*) Këtu mund të përfshihen edhe të tjerë.

## Një zhvillim i afërtë në përgjithësi, në kulturat që nga zanafilla

Sikurse në shkallët e zhvillimit nga fëmija deri tek njeriu i pjekur (shiko lart), shkallë të ngjajshme të zhvillimit janë kaluar edhe në kulturat njerëzore. Këto në njërin anë sillnin aftësi të reja (një të dëshiruar, të ndjerë dhe të menduar më e lirë), mirëpo në anën tjetër zvoglonin mirënjohjen e saj fillestare me tërë „krijesën" dhe përmes kësaj grumbullonin probleme (*krahaso p.sh. Jean Gebser, "Zanafilla dhe e tanishmja"*: vetëdije njëra pas tjetrës arkaike, magjike, mitike e arsyes; përveç kësaj mund të zhvillohet një vetëdije më fortë e integrueshme, e cila mund të quhet p.sh. vetëdije e logjikës.) Edhe shembëlltyra të ngritura kanë bashkëvepruar aty që të mund të zhvillohen hapa zhvillimor, siç ishin të dallueshëm që nga

bërthama në përgjithësi, së paku mundeshin të shtrihen në përmasa vendimtare kulturore. Kjo ndodhi përkundër të gjitha pengesave, por, siç u përmend, shpeshherë me humbje të mëdha. Në kohën më të re veçmë është e dukshme se njerëzimi dhe popujt e tij etj. qëndrojnë para një sfide të fatit që prapë të realizojë „kërcime të kuanteve” apo hapa evolucionit më të vogla ose më të mëdha, nëse dëshirojnë që të mbijetojnë <sup>4)</sup>. Këto janë të caktuara qysh gati 2000 vjet. Kjo nuk duhet më të ndodhë mbi shpenzimet e aftësive të arritura sikurse të arsyes. Nëse individë të mjaftueshëm zhvillojnë një vetëdije logjike gjithnjë më të tërësishme, nëse lidhen sërish me zanafillën e tyre hyjnore, gara me katastrofat apokaliptike mund të fitohet ende me ndihmën nga „Iart”. Këtu bënë pjesë edhe një marrëdhënie me lëvizjet e jashtme të aktivistëve si lëvizja paqësore etj., të gjithë dashamirët e kanë vendin e tyre "të nevojshëm" në "lojë" Shumë njerëz, nëpër të gjitha drejtimet e etabluara fetare, e kërkojnë me gjasë atë vend; ata shkojnë përpara në të ardhmen dhe ndihmojnë që të përpunohet e kaluara, edhe nëse shumë mesatare ende mund të sundojnë. Është çështja e pulës dhe e vezës, se a është "shpëtimi" i jashtëm qëllimi apo përparimi ekzistencial i vetëdijes dhe i qenies së njeriut. Shkallat e deritanishme të vlerave duhet pashmangshëm të transformohet, sepse njeriu mundet mjaft saktë të parafytyrojë se kah duhet të shpiej vazhdimi i programit të deritanishëm të vjetruar. Sikurse çdogjë pjesë e së tërës është, ashtu edhe secila vepër e mirë hyn në të tërën.

- 4) Shikimi pesimist në librin e fundit të Herbert Gruhl "Ngjitja në qiell në asgjë" nuk mund të pohohet vetëm për atë arsye, sepse mund të preket vetëm një burim i harruar prej tij i zhvillimit gjegjësisht fuqisë, e cila megjithëkëtë paraqet vetëm një gjasë: Zotin.

Inspiro njerëzit, që vendimet për jetë dhe vdekje ti lënë në duart e Tua \*;  
Ndhmoju atyre që punojnë për krijesën Tënde;  
Udhëhiqe Ti këtë botë kah depërtimi tek koha Yte e re e premtuar.\*\*

\*) Këtu mund të përfshihen edhe detaje ose më pastaj të përpunohen në një trajtim meditativ; p.sh. të mbarojë lëkundja e dhunës dhe kundërdhunës', 'dhunës t'i largohet baza përmes zgjidhjes së problemeve', 'të zhvillohet një dialog paqësor ndërmjet dashamirësve të religjioneve', ... .

\*\*) *Luka 11:2; 21:31. Zbulesa 11:16.* Zoti mund ta ndajë dashurinë që atij i jipet..

**Do të thotë vjen një „kthesë” kah Zoti në të vogël dhe në të madhe**

**Gjoni 16, 12-13: Kam për t’u thënë edhe shumë; por ju tani nuk mund t’a duroni. Por kur të vjen fryma e të vërtetës, ajo do t’ju udhëheqë me të gjithë të vërtetën. Sepse ajo nuk do të flas nga vetëvetja; por çka do të dëgjojë, atë do ta flas, dhe çka do të jetë e ardhshme, do t’ua kumtojë.**

## Rrugët e Krishtit

**Bazat e vlerave etike**



Jezu Krishti i jepte rëndësi të madhe asaj që standardi për sjelljen etike, morale të jetojë në njeriun e veçantë, në vend që të ndikoj vetëm në bazë të presionit të një norme ose zakoni ligjor të jashtëm. Ky shpirtëzim poashtu nuk krijohet përmes një „ngulitjeje” nga jashtë, por përmes një jete në të cilën mund të shtjellohet „dashuria ndaj Zotit, e ndaj të afërmit sikurse ndaj vehtes”. "Duani njëri-tjetrin" (*Gjoni 13,34*) është forca e cila mundëson që të veprohet në harmoni me ndërgjegjen e vërtetë. Dashuria ndaj Zotit lejon që të nuhaten qëllimet e tija më të larta. Aty ku individët, çiftet, grupet etj. përfshijnë këtë dashuri univerzale, dallimi do të jetë i dukshëm. Sa më shumë që kjo të jetojë në të gjitha, aq më të parëndësishme bëhen rregullat e jashtme, të detajuara.

Megjithatë përmes kësaj përmbajtjet, siç janë dhënë për shembull në „10 urdhërimet” më të vjetra, nuk janë të vjetruara si të tilla, por janë vërtetuar. Ato nuk janë të nënshtruara në bazat, por në detajet e transformimit kulturor. Këtë e dëshmon qysh raporti i vet Moisiut, i cili fillimisht kishte të ndërmjetësuar një formë më të lartë të etikës, por i cili popullsisë siç duket të papjekur për këtë ia solli pastaj një version më të thjeshtë. Këto baza etike në krishterizëm, në çifutëri dhe në islam janë të në këtë pikëpamje të njëjtat dhe praktikisht në të gjitha fetë e tjera gjindet diçka e afërt, siç u tregua në „Deklaratën e Parlamentit të Religjioneve Botërore rreth zakonit botëror (shiko faqen e linkut tonë). Në thelb tek etika bëhet fjalë që të tjerët të trajtohen në mënyrë aq njerëzore, siç dikush vet dëshiron që të trajtohet; të tjerën do me thënë jo të dëmtohen, por për më tepër të ndihmohen. Kjo është e rëndësishme për fatin, sepse „çka mbjellni, atë do të korrni” (*Gal 6,7; 2 Kor 9,6*). Së fundi kjo është edhe kriteri kryesor për pjesëmarrje në atë kohë të re, për të cilën në **lutjen „Ati ynë”** thuhet „Ardhtë Mbretëria jote!” (*Mateu 6*) dhe për të cilën në predikimin në mal thuhet „Lum ata që janë të butë sepse do ta trashëgojnë tokën!”

Në kuptimin e gjerë nga kjo dalin pikëpamje të cilat për rrafshet e ndryshme të ekzistencës njerëzore janë jetësore. Etika e predikimit në mal sot edhe nga disa rrethe të krishtera gabimisht cilësohet si „etikë bindjeje” që nuk aplikohet drejtpërdrejtë. Ajo vërtet nuk jep automatikisht një udhëzim për veprim p. sh. për të gjitha vendimet e vështira politike. Por, në fund edhe për këtë do të ishte një zhalon. Ku një e ashtuquajtur „etikë përgjegjësie” e peshuar njerëzisht në shoqëri shpien deri tek vendimet e kundërta nga ato të cilat „etika e bindjes” i pret nga individi në jetën e tij private, automatikisht nuk do të guxohet të pritet se Jezusi këtë pokështu do ta vendoste.

Individi është përgjegjës për pjesën e tij të ndodhisë dhe këtë pjesë nuk mund ta baraspeshojë edhe me gabimet e të tjerëve. Një lënie e tillë e njëanshme e fajit nuk është gjithmonë korrekte, siç është e zakonshme tek çështjet (proceset) gjyqësore. Edhe grupet e kështu me radhë, përmes detyrimeve që ushtrojnë, gjegjësisht përmes „fushës së mësimi” pozitiv ose negativ të clin e paraqesin, bartin bashkëpërgjegjësi. Me këtë edhe ata do të kishin nevojë për një kodeks etik (siç e kanë p. sh. disa degë të profesioneve). Tej etikës individuale sipas kësaj kërkohet edhe një „etikë strukturale” e shoqërisë gjegjësisht e pjesëve të saj. Ligjet me arbitraritetin e tyre këtë nuk mundën vetë ta zëvendësojnë.

<p><b>rdhërimet e Moisiut</b> (Moisiu 2 = Eksodi 20)</p>	<p><u><b>Etika në Kuran</b></u></p>	<p><b>"Zakoni botëror"</b> (shiko faqen e linkut tonë)</p>
Empty space for content		

<p>1. Unë jam Zoti Hyji yt. ...Mos ki tjetër Zot, përveç meje. (Mos bëj kurrfarë idhulli...)</p> <p>2. Mos e merr nëpër gojë kot emrin e Zotit, Hyjit tënd (sepse Zoti s'do ta lërë pa ndëshkuar atë që do ta marrë nëpër gojë kot emrin e tij.)</p>	<p>E mos shoqëro me Zotin ndonjë zot tjetër... (Sure 17,22*)</p>	<p>(Kuptimi për një „zakon botëror“ nuk kishte të bënte me nocionin e Zotit në religjionet e ndryshme P. sh. për shkak të budistëve të gjithë e kishin të përbashkët që të pranojnë një „Realitet të Fundit“, d.m.th. diçka përtej realitetit material.)</p>
<p>3. Të bie në mend ta shenjtërosh festën / të shtunën ...</p>	<p>...Në ditën e thirrjes kthehuni kah ... aty ku përmendet Zoti ... (sure 62,9*)</p>	
<p>4. Nderoje babën tënd e nënën tënde (që ta kesh jetën e gjatë përmbi tokë që do ta japë Zoti, Hyji yt.)</p>	<p>Ndaj prindërve duhet të sillesh mirë..., thuaju fjalë të mira me nderim ...; dhe jepi të afërmit, çka i takon ... (Sure 17,23-26*).</p>	
<p>5. Mos vraj!</p>	<p>Mos e mbyt asnjërin, që Zoti e ka ndaluar të vritet... (Suret 17,33 dhe 5,32*).</p>	<p>Obligimi për një kulturë të mosdhunës dhe të nderimitit të thellë për jetën e të gjithëve...</p>
<p>6. Mos bëj kurorëthyerje!**</p>	<p>Dhe mos iu afroni zinasë (amoralitetit)! (Sure 17,32)</p>	<p>Obligimi për një kulturë të barazisë dhe partneritetit të burrit dhe gruas, (kundër sjelljes destruktive me seksualitetin ...)</p>
<p>7. Mos vidh!</p> <p>9. Mos i lakmo shtëpisë së të afërmit tënd.</p> <p>10. Mos i lakmo gruas së të afërmit tënd, shërbëtorit, shërbëtores, as kaut, as gomarit e asnjë gjëje që i përket atij.</p>	<p>Kur një burrë apo një grua ka vjedhur, preja atyre duart ... por kur dikush ... pendohet dhe përmirësohet, Zoti do t'ia falë ... (Sure 5,38-41*)</p>	<p>Obligimi për një kulturë të solidaritetit dhe një rendi të drejtë ekonomik...</p>
<p>8. Mos bëj dëshmi të rrenë kundër të afërmit tënd / mos gënjeu</p>	<p>Jeni dëshmitarë ... për të drejtën, edhe nëse është kundër vetvetes suaj ose kundër prindërve apo të afërmeve... sure 4,135* (në lidhje me mashtrimin shiko suren 2,188*)</p>	<p>Obligimi për një kulturë të tolerancës dhe një jetë në çiltërsi...</p>

\*) në numrin egjiptian të verseve që përdoret më së shumti në vendet islamike; në numrit tjera të verseve është e mundshme që versi të qëndrojë p.sh. një vers më vonë.

\*\*) Kësaj i janë lidhur veçanërisht shumë detaje të dallueshme nga religjionet e ndryshme. Kjo mund të krijoj kuptimin se pikërisht jo për të gjithë duhet të jenë të sakta të njëjtat hollësira. Poashtu më parë për qëllimet e sotme shpeshherë nuk është dalluar mjaftueshëm ndërmjet principeve fetare dhe ligjeve botërore të detajuara; por kjo nuk do të thotë që do të ishte e lakmueshme, nëse feja dhe ligji tregojnë kundërthënie gjithnjë e më të mëdha.

Mund të jetë e ndihmueshme, nëse mospërsosshmërit e konstatuara dhe tiparet pozitive të shënohen si një tabelë që përparimi të përcillet me vetëdije. Ekzistojnë disa mundësi që të punohet në këtë pikë:

1. Puna direkte me tiparet vetjake problematike në bazë të ngjarjeve në jetë. Synime të mira etj. Kjo mbetet e rëndësishme edhe tek Jezusi: "së pari traun në syrin e vet..." (Mt 7,1-5). Edhe tek **feja islame** puna tek vetvetja vlen si „Xhihad i Madh”, „Lufta e Madhe e Shenjtë”, d.m.th. si diçka që është më vendimtare se sa çdo rregullim i jashtëm.

2. Zhdëmtimi direkt dhe 3. falja direkte njëri-tjetrit, nëse kjo është e mundshme. Përndryshe problemet në lutje i përcillen Zotit për zgjidhje të mëtejme dhe në brendi falen. Edhe kjo tek Jezusi mbetet e rëndësishme, edhe ai flet për përpunimin „deri në të sprasmin qindar” (Lk 12,59; *shiko me poshtë nën: 5*.)

4. Aty ku ndryshe nuk është e mundshme, ekziston edhe mundësia e veprave të mira përkatëse për të tjerë nga ata të cilëve u është shkatuar dëmi. Shumëçka edhe në mënyrë indirekte spastrohet nga Zoti, nëse dikush p.sh. merr përsipër detyra të dobishme për të gjithë. (Këtu është edhe një kalim i rrjedhshëm nga përpunimi i pastër i të deritanishmes në veprime të lira, ndihmëse dhe mandej bëhet relative, se 'kush mbjell e kush korr', *krahaso p. sh. Gjn. 4,37.*) Këtu vlen sipas Mt 7,20-21: "...në frytet e tyre do t'i njihni. Jo secili që më thotë: O Zot, O Zot! do të hyjë në Mbretërinë e qiellit, por ai që kryen vullnetin e Atit tim që është në qiell".

5. "Lutju Zotit në emrin tim", këtu për faljen dhe mëshirën e tij në zhvillimin e mëtejme të jetës. Kjo është ndihma kryesore të cilën një etikë thjesht humaniste nuk mund ta jep. Fati nuk ka nevojë pastaj më të rrjedhë mekanikisht, por njeriu përjeton veten si i udhëhequr nga Zoti, gjithçka do të përpunohet dhe zhvillohet më tej, siç është më mirë nga urtësia e tij më e lartë për individin dhe rrethin e tij.

(...)

## Rrugët e Krishtit

### Aspekte krishtere për ekonominë dhe për çështjet sociale

Së pari duhet të udhëzohet në atë, se njeriu edhe pas hulumtimeve më të reja ekonomike nuk është ajo qenie puro egoiste, të cilën e prejdukonte teoria e deritanishme liberale për ekonominë. Vetëm një pakicë vepron thjesht vetëm për shkak të interesave vetjake. Për shumicën e njerëzve një rol poashtu të madh dhe shpesh vendimtar luajnë vlera të tjera si bashkëpunimi reciprok vullnetar. Ky „altruizëm reciprok" sikurse edhe egoizmi megjithatë shpie automatikisht aq pak deri tek më e mira e shoqërisë së tërësishme, por mund të ndikojë në kuptimin e krijimit të klikave. Aty ndihmojnë më tej vetëm vendime të mirëfillta, konsekuente etike.

Këtu mund të vëhen aspekte psikologjike dhe fetaro-etike. Njeriu është krijuar në të njëjtën masë si qenie individuale dhe si qenie sociale. Si një vetëdije e shëndoshë, jo e stërngritur, ashtu edhe një qëndrim solidar ndaj njerëzve përreth mund të ushtrohen në rast të çiltërsisë përkatëse. Aty ku duket se ekziston vetëm ana egoiste, ana altruiste ose nuk është fort e zhvilluar ose përmes „shkollimit" të fortë përmes shoqërisë perëndimore është tkurrur. Shoqëritë socialiste theksonin njëanshëm solidaritetin dhe në anën e kundërt anën liridashëse individualiste të njeriut e linin shpeshherë të tkurret, andaj edhe nuk i përgjigjeshin asaj për çka është krijuar njeriu. Aty ku njerëzit nuk gjejnë raporte të barazuara, këtë ata e tregojnë herët apo vonë përmes kritikës e kështu me rradhë. Pastaj ose mësohet diçka më tepër me kohë, ose herët apo vonë mirret tatëpjeta. Kjo vlen edhe për formën ekonomike që mbisundon sot dhe e cila karakterizohet nga ndërmarrje të mëdha që veprojnë globalisht. Jezusi këshillon që së pari të sqarohen problemet gjegjëse shtëpiake (*Mateu 7*).

Vërtet vlerat e prediktit në mal (*Mateu 5-7*) \*\* etj. nuk mund të përkthehen drejtëpërdrejt në udhëzimet e veprimeve shoqërore. Megjithatë skizofrenia nuk do të ishte në kuptimin e Jezusit, p.sh. në jetën private të veprohet sipas udhëzimeve të dashurisë ndaj të tjerëve, ndërsa në funksionet e punës apo të shoqërisë të aplikohen parime krejt të kundërta. Një etikë serioze \*\*\* duhet të dëshmohet në të gjitha rrafshet dhe fundi i

fundit duhet të vlejë për botën në tërësi. P.sh. vlera e zemërmirësisë dhe që Jezusi edhe në praktikë u është drejtuar pikërisht të varfërve ka rëndësi shoqërore padyshim edhe përtej shërbimeve të njohura kishtarë sociale, edhe për sjelljen njerëzore brenda ndërmarrjes. Edhe *Mateu 22,14 / Marku 12:17* ka rëndësi tejet praktike, ashtu që aty krahas zemërmirësisë vërtetohet edhe „e dhjeta” e trashëguar nga Jezusi, d.m.th. krahas tatimit romak ekzistonte edhe një ndihmë 10%-she për qëllime fetare gjegjësisht bëmirese. Megjithatë, duke u bazuar në Jezusin, gatishmëria për të ndihmuar është e bazuar në vendimet vullnetare; por nga ajo nuk është e mundur në mënyrë direkte për të përfutur koncepte të ri-klasifikimit të detyruar. Por këshillat morale numër 9 dhe 10 janë akoma të vlefshme "Ju nuk do duhej të lakmoni....çfarë ka në pronësi fqinji juaj." Përkundër të gjitha përpjekjeve tona për të arritur një përmirësim të situatës sociale për shumë njerëz, fatet tona të ndryshme mbetën në duart e perëndisë.

Barazia në *Mateu 25,14-30 / Luka 19* merr rrethana të njohura materiale. Lidhshmëria (tek Luka p.sh. qëndrimi etik i një doganieri, tek Mateu p.sh. barazia paraprirëse rreth forcave besuese të virgjërshave) tregon megjithatë, se me këtë duhet të sqarohet diçka më përfshirëse se sa shumimi i mallrave materiale gjegjësisht financave. Kjo shprehet edhe më qartë p.sh. tek *Luk. 12,33*, ku vlerat shpirtërore vendosen mbi ato tokësore. Megjithatë sjellja e përgjegjshme me mallra të besuara lidhet edhe me çështje materiale. Edhe aty ku për shembull këshillohet që të ndihmohen të varfërit dhe të dëmtuarit, i jipet një vlerë kësaj përkrahjeje materiale ose financiare në vend që çështja materiale të përgjithësi të trajtohet si i pavlerëshme. E rëndësishme është për shembull, se a janë të hollat qëllim në vetvete apo ato përdoren për diçka më të arsyeshme - *Mateu 6,24*: pamundësia që t'i shërbesh njëkohësisht Zotit dhe parasë.

P.sh. të gënjeshtër dhe të mashtrosh, të bëjshë mobing, dhe të krijosh projekte, padjallëzia e të cilëve për bashkëqytetarët (jokriminel) dhe për krijesat e tjera nuk është e dëshmuar mjaftueshëm, nuk është në kuptimin e një bashkëjetese të vetëdijshme siç e ka demonstruar Jezusi në çdo hap të tij. Jezusi poashtu nuk na ka mësuar, që të radhë të parë gjithnjë të vendosim të ashtuquajtura „detyrime materiale”. Këtu bëhet fjalë edhe për sinçeritetin dhe barazinë.

Nga feja islame na është e njohur, se interesi (kamata) është i ndaluar. Por edhe çifutët dhe të krishterët mund të gjejnë këshillime të tilla në Bibël.

*Ezekieli 18:8 dhe 9*: Ai që nuk jep hua me interes dhe nuk jep me fajde, që heq dorë nga paudhësia, që mes njerëzve gjykon me paanësi dhe urdhërave të mia u përmbahet duke vepruar me besnikëri, ai është i drejtë dhe do ta ketë jetën, foli ZOTI ZOTI.

Shiko edhe *Esdra 7:24* (Ndalimi për interes, doganë dhe taksa ndaj profesioneve të caktuara); në anën tjetër *Fjalët e urta 28:8* mund të trajtohet ashtu, që bëhet fjalë edhe për atë se si në fund mund të përdoren edhe të hollat e fituara nga interesi.

Shiko edhe *Mateu 23:23* dhe *Mateu 17:24*.

Bibla e sugjeron shmangien e rënies në borxhe të panevojshme (*Citatet 22:7*), dhe rekomandim të parashikuar (*Citatet 21:5*), si dhe rritje të mençurisë dhe diturisë gjatë gjithë kohës (p.sh. *Citatet 4:5-8*). Nga njerëzit kërkohet ruajtja e mallrave apo të hollave, dhe çdo vit do duhet ruajtur "të dhjetën" a asaj që mbjellë për të qenë në gjendje për të udhëtuar në festat religjioze, dhe për të dhënë donacione (*Deuteronomi 14:22-27*). Shën Pali e bëri një kërkesë për krishterët, që ata të ruajnë çdo javë nga ndonjë gjë, dhe pastaj në rast nevojë për ti ju dhënë krishterëve të tjerë nëse kanë probleme (*1. Kor. 16:1,2*), dhe sugjeron një qëndrim të moderuar në lidhje me mallrat jofetare (*1. Tim. 6:8*). Jezusi shpreson se njeriu duhet të llogarisë mirë nëse ka të holla të mjaftueshme, p.sh. para se të fillohet me një projekt të ndërtimit (*Luka. 14:28*). Sot ekonomia e qëndrueshme do të ketë shumë kërkesa, për terapi dhe për parandalim: mbingarkesa me borxhe private, komerciale dhe publike është shkaku kryesor i jo-stabilitetit në mbarë botën financiare. Uebajdi i internetit Rrugët e Jezu Krishtit nuk ka ndonjë qëllim politik; por ne jemi këtu vetëm për të dhënë pikëpamje të përgjithshme.

\*) Sipas Ernst Fehr, drejtor i Institutit për Hulumtime Empirike Ekonomike pranë Universitetit të Zyrihut, në intervistën për revistën "Spektrum der Wissenschaft" mars 2002, "Altruizmi reciprok...".

\*\*) Në kuptimin më tepër shpirtëror këto vlera sqarohet edhe në *Kapitullin rreth predikimit malor në tekstet kryesore në gjuhët e tjera*.

\*\*\*) Shiko edhe faqen tonë të posaçme "[Bazat e etikës](#)".

**[Kthehu në faqen fillestare http://www.ways-of-christ.com/sq](http://www.ways-of-christ.com/sq)**

Rrugët e Jezu Krishtit, kontributet e tij për vetëdijen e njeriut dhe për ndryshimet e njerëzisë dhe tokës: një faqe informative e pavarur, me pikëpamje të reja nga shumë fusha të hulumtimeve dhe sfera të përvojës; me udhëzime praktike për zhvillimin personal.

**<http://www.ways-of-christ.com/sq>**

### **Udhëzim: e drejta e kopjimit**

**Këtë faqe të internetit guxoni t'a shtypni dhe kopjet me përmbajtje të pandryshuar t'i shpërndani.**

Prodhuar 1991 - 2014; E publikuar në internet për herë të parë më 30.01.2001; ky është një insert i ri në gjuhën shqipe nga tekste e plota. Ky verzion i plotë ekziston në shumë gjuhë.

Autori: Projekti Rrugët e Krishtit (Christuswege/ Ways of Christ™).

Faqja e internetit „Rrugët e Krishtit“ është një projekt hulumtimi dhe informimi. Ai është i pavarur nga kishat, fetë dhe komunitetet e tjera fetare (mirëpo edhe nuk drejtohet kundër asnjërës prej tyre). Kjo faqe e rrjetit nxit marrëdhëniet paqësore dhe kuptimin më të thellë ndërmjet religjioneve. „Rrugët e Krishtit“ nuk synon ndonjë fitim ekonomik apo ndikim politik. Rrugët e Krishtit nuk misionon dhe nuk kërkon anëtarë.

E-Mail për Rrugët e Krishtit: [ways-of-christ.com](mailto:ways-of-christ.com) . Ju lutemi të na shkruani mundësisht në anglisht, gjermanisht ose frengjisht.

...